


Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Mars 2025

Tiranë, më 08 Prill 2025: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Mars 2025, arriti 119,7 kundrejt muajit Dhjetor 2020.

Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Mars 2025 është 2,1 %, një vit më parë ky ndryshim ishte 2,3 %. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Mars 2025, krahasuar me Shkurt 2025 është 0,6 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)




Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Mars është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +1,04 pikë përqindje, pasuar nga grupi “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me +0,26 pikë përqindje. Gjithashtu, çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” ndikuan me +0,22 pikë përqindje, çmimet e grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me +0,17 pikë përqindje, çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” me +0,16 pikë përqindje, çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” me 0,11 pikë përqindje, çmimet e grupit “Hotele, kafene dhe restorante” me +0,10 pikë përqindje, çmimet e grupit “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me +0,07 pikë përqindje, çmimet e grupit “Komunikimi” me +0,04 pikë përqindje, çmimet e grupit “Shërbimi arsimor” me +0,03 pikë përqindje, çmimet e grupit “Shëndeti” me +0,02 pikë përqindje dhe çmimet e grupit “Transporti” me -0,15 pikë përqindje.

Për publikim 08/03/2025

Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Mars 2024, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Argëtim dhe kulturë” me 7,4 %, pasuar nga grupet “Pije alkoolike dhe duhan” me 4,4 %, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 3,5 %, “Ushqime dhe pije joalkoolike” dhe “Veshje dhe këpucë” me 3,0 % secili, “Hotele, kafene dhe restorante” me 1,9 %, “Komunikimi” me 1,5 %, “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 1,3 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” dhe “Shërbimi arsimor” me 0,9 % secili, “Shëndeti” me 0,6 %. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Transporti” shënuan ulje me 2,5 %.

Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “qumësht, djathë dhe vezë” patën një rritje me 4,6 %, pasuar nga nëngrupet “zarzavate përfshirë patatet” me 4,0 %, “mish” me 3,3 %, “sheqer, recel, mjaltë, çokollata dhe mbëlsira” me 1,2 %, “peshk” me 0,1 %, etj.

Ndryshimet mujore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Shkurt 2025, çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” shënuan rritje me 1,3 %, pasuar nga grupet “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 1,2 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0,5 %, “Pije alkoolike dhe duhan” dhe “Komunikimi” me 0,2 % secili, “Veshje dhe këpucë”, “Transporti”, “Hotele, kafene dhe restorante” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,1 % secili. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” shënuan ulje me 0,1 %.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2020=100

Kodi	Grupet	Peshat	03-24	04-24	05-24	06-24	07-24	08-24	09-24	10-24	11-24	12-24	01-25	02-25	03-25
	Gjithsej	100	117,3	117,1	116,8	116,4	116,2	116,8	117,5	117,6	117,6	118,3	118,7	119,1	119,7
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	34,3	133,4	132,5	131,5	130,0	129,0	130,3	132,1	132,6	132,2	133,4	134,7	135,9	137,4
2	Pije alkoolike dhe duhan	4,9	112,9	113,4	113,6	114,0	114,3	114,7	114,8	115,2	115,4	116,7	116,9	117,6	117,8
3	Veshje dhe këpucë	3,9	108,8	108,9	109,2	109,6	110,1	110,8	111,4	111,8	112,5	112,9	112,5	111,9	112,0
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,1	107,7	107,6	107,7	107,7	107,8	108,1	108,2	108,0	108,3	108,5	108,4	108,1	108,6
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	7,5	113,9	114,2	114,8	115,1	115,1	115,5	116,0	116,1	116,3	117,4	117,8	118,0	117,9
6	Shëndeti	3,5	103,9	104,0	104,0	104,0	104,0	104,1	104,1	104,3	104,2	104,4	104,4	104,6	104,6
7	Transporti	6,1	111,6	111,8	110,5	110,0	110,1	109,3	109,2	108,6	108,0	108,7	108,7	108,8	108,9
8	Komunikimi	3,0	104,9	104,9	105,0	105,0	105,1	105,6	105,8	105,8	105,8	106,2	106,2	106,2	106,4
9	Argëtim dhe kulturë	2,3	112,0	113,2	113,9	113,9	113,3	115,3	117,5	117,9	117,7	117,5	117,8	118,8	120,3
10	Shërbimi arsimor	3,4	105,1	105,1	105,2	105,1	105,2	105,4	105,8	105,9	106,0	106,0	106,1	106,1	106,1
11	Hotele, kafene dhe restorante	5,7	113,8	114,0	114,1	114,2	114,7	115,0	115,0	115,3	115,3	115,6	115,6	115,8	115,9
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	5,6	107,3	107,4	107,6	107,5	107,6	107,8	107,9	107,9	108,1	108,2	108,5	108,7	108,7

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

Kodi	Grupet	03-24/03-23	04-24/04-23	05-24/05-23	06-24/06-23	07-24/07-23	08-24/08-23	09-24/09-23	10-24/10-23	11-24/11-23	12-24/12-23	01-25/01-24	02-25/02-24	03-25/03-24
	Gjithsej	2,3	2,1	2,2	2,1	2,1	2,0	1,9	1,9	2,0	2,1	1,9	1,9	2,1
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	2,0	1,5	1,9	2,0	1,9	2,4	2,7	3,1	3,2	3,0	2,6	2,8	3,0
2	Pije alkoolike dhe duhan	3,3	3,3	3,1	3,3	3,1	3,6	3,5	3,6	3,8	3,8	3,9	4,5	4,4
3	Veshje dhe këpucë	3,3	3,4	3,2	3,2	3,3	3,9	3,6	3,5	4,0	3,8	3,3	2,8	3,0
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	2,4	2,3	2,2	2,2	2,2	1,5	1,5	1,2	1,4	0,9	0,9	0,4	0,9
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	4,2	3,5	3,7	3,7	3,5	3,5	3,6	2,9	3,3	4,2	3,9	3,6	3,5
6	Shëndeti	1,9	1,7	1,7	1,7	1,5	1,4	1,1	1,2	1,1	1,1	0,9	0,6	0,6
7	Transporti	-0,3	1,0	1,1	0,9	0,3	-3,1	-4,5	-5,3	-5,4	-2,8	-2,5	-2,2	-2,5
8	Komunikimi	0,2	0,0	0,1	0,1	0,2	0,6	0,8	0,8	0,8	1,2	1,2	1,2	1,5
9	Argëtim dhe kulturë	3,8	4,4	3,7	1,9	2,2	4,0	4,6	5,0	5,7	5,6	5,7	6,5	7,4
10	Shërbimi arsimor	2,3	2,2	2,2	2,1	2,2	2,2	0,9	0,7	0,8	0,8	0,9	0,9	0,9
11	Hotele, kafene dhe restorante	3,5	3,2	2,4	2,2	1,9	1,8	1,8	1,8	1,8	1,8	1,7	1,8	1,9
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	3,3	2,7	2,5	2,2	2,1	2,1	1,9	1,9	1,9	1,5	1,6	1,4	1,3

%

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

Kodi	Grupet	03-24	04-24	05-24	06-24	07-24	08-24	09-24	10-24	11-24	12-24	01-25	02-25	03-25
	Gjithsej	0,4	-0,2	-0,2	-0,4	-0,2	0,5	0,6	0,1	0,0	0,6	0,4	0,3	0,6
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	1,0	-0,7	-0,7	-1,1	-0,7	1,0	1,4	0,3	-0,3	0,9	0,9	0,9	1,2
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,2	0,5	0,2	0,3	0,3	0,4	0,1	0,3	0,2	1,1	0,2	0,6	0,2
3	Veshje dhe këpucë	0,0	0,1	0,2	0,4	0,5	0,6	0,5	0,4	0,6	0,3	-0,3	-0,5	0,1
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,1	0,0	0,1	0,0	0,0	0,4	0,1	-0,2	0,3	0,1	0,0	-0,3	0,5
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,1	0,2	0,5	0,2	0,1	0,3	0,5	0,1	0,2	1,0	0,3	0,2	-0,1
6	Shëndeti	0,0	0,1	0,0	0,0	0,0	0,1	0,0	0,1	-0,1	0,2	0,1	0,1	0,0
7	Transporti	0,3	0,2	-1,1	-0,4	0,0	-0,7	-0,1	-0,5	-0,5	0,6	0,0	0,1	0,1
8	Komunikimi	0,0	0,0	0,1	0,0	0,1	0,4	0,2	0,0	0,0	0,4	0,0	0,0	0,2
9	Argëtim dhe kulturë	0,4	1,1	0,6	0,0	-0,5	1,8	1,9	0,4	-0,2	-0,1	0,2	0,9	1,3
10	Shërbimi arsimor	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	0,2	0,4	0,1	0,1	0,0	0,1	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,1	0,2	0,1	0,1	0,4	0,3	0,0	0,2	0,0	0,2	0,0	0,2	0,1
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,1	0,1	0,1	0,0	0,1	0,2	0,1	0,0	0,2	0,1	0,3	0,2	0,1

%

Metodologjia

Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2023.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga 331 produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mbliidhen çmimet.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit duke filluar nga muaji Janar 2021 llogaritet me bazën e re. Muaji Dhjetor 2020 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2020 = 100).

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.